REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 866/20
Datë/Datum. 24.11.20
PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.866/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "G&A Consulting" SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Softaj", me nr. të prokurimit 656-20-4406-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj, më datë: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "G&A Consulting" SH.P.K-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Softaj", me nr. të prokurimit: 656-20-4406-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj.

II. **ANULOHET**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Softaj", me nr. të prokurimit: 656-20-4406-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "G&A Consulting" SH.P.K - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 3 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "G&A Consulting" SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.09.2020 me nr. 866/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i objektit të QMF-së në Fshatin Softaj" , me nr. të prokurimit: 656-20-4406-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KK-Ferizaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 42, 52, 54, 59, 62, 72 dhe 108/A pika 6 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 11.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
OE ankues pretendon që AK na ka diskriminuar neve si OE për faktin se vetëm ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk na është dhënë qasje në dokumente dhe nuk është marrë për bazë kërkesa për rishqyrtim, nuk na ka kthyer përgjigje. Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën e prokurimit elektronik, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me pikën 3,4,5 të nenit 10 të LPP-së, ku thuhet:
Pika 3 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga

një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (I) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (II) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (III) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

Pika 4 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave

Pika 5 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

OE ankues pretendon që AK nuk e ka njoftuar me rezultatet e tenderit dhe pa asnjë dokument relevant e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Lidhur me këtë pretendim, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka dhënë një arsyetim krejt të thjeshtë për shkak të anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe nuk është respektuar dispozita e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet:

Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Duke pas parasysh sqarimet e lartëpërmendura, eksperti shqyrtues vlerëson që nuk është plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që AK mund të vazhdojë me vlerësim të ofertave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdojë me vlerësimin e ofertave.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 11.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:
Pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues të lëndës tonë lidhur me projektin në fjalë. Ne gjithashtu konsiderojmë se ankesa jonë është plotësisht e bazuar dhe kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të vendosë në favor të ankesës sonë, duke marrë për bazë mendimin e ekspertit shqyrtues:
-Të anulohet vendimi për anulim I AK dhe
-Të kthehet lënda në rivlerësim (ose vlerësim) sepse nuk është vlerësuar dhe AK të vazhdojë procedurën e prokurimit më tutje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "G&A Consulting" SH.P.K-Prishtinë, se AK na ka diskriminuar neve si OE për faktin se vetëm ka bërë anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe nuk na është dhënë qasje në dokumente dhe nuk është marrë për bazë kërkesa për rishqyrtim, nuk na ka kthyer përgjigje. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me pikën

3,4,5 të nenit 10 të LPP-së, ku thuhet:

Pika 3 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës që kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (I) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (II) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (III) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.

Pika 4 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga paragrafit 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave

Pika 5 e Nenit 10 të LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3 të këtij neni.

OE ankues "G&A Consulting" SH.P.K-Prishtinë, pretendon që AK nuk e ka njoftuar me rezultatet e tenderit dhe pa asnjë dokument relevant e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Lidhur me këtë pretendim, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK ka dhënë një arsyetim krejt të thjeshtë për shkak të anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe nuk është respektuar dispozita e nenit 62 të LPP-së, ku thuhet: Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të

autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Andaj, Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh sqarimet e dhëna si më lartë, vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe AK duhet të bëjë vlerësimin e tenderëve në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Ferizaj;

1x1 OE "G&A Consulting" SH.P.K – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.